



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:147961

Datë: 20.07.2022

Numri i dokumentit: 03245263

P.nr.2020/147961

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC/Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Shemsije Shehu, në lëndën penale kundër të akuzuarve: **A. S.** nga fshati Çifllak, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 184/3-3.1 të KPRK-së, dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor në bashkryerje nga neni 185/1-1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, **D. S.** nga fshati Çifllak, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor në bashkryerje nga neni 185/1-1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, të akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.836/2020 të datës 25.01.2021, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur me datë 19.07.2022, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Nazmi Krasniqi, të akuzuarve A. dhe D. S., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

A. S., nga i ati R., dhe e ëma Sh., e lindur B., i lindur me dt...., në fshatin Çifllak, Komuna e Rahovecit, ku dhe tani jeton, me numër personal ..., ka të kryer fakultetin e Edukimit, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër për ndonjë vepër penale,

D. S., nga i ati R., dhe e ëma Sh., e lindur B., i lindur me dt...., në fshatin Çifllak, Komuna e Rahovecit, ku dhe tani jeton, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i ati i katër (4) fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i padënuar, ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër për ndonjë vepër penale,

JANË FAJTORË

I.

I akuzuari A. S.,

Më 31/07.2020 në fshatin Çifllak, Komuna e Rahovecit, me dashje përdorë forcën ndaj personit tjetër ashtu që pasi atë ditë kishin bërë fjalë mes veti të miturit L.S. dhe Sh. K. i pandehuri pasi del me veturë takon në rrugë të miturin SH.K. të cilin e godet me shuplaka në

kokë dhe fytyrë dhe largohet nga aty, me çka në këtë mënyrë me dashje, përdorë forcën fizike duke sulmuar fizikisht të miturin e lartcekur.

Me këtë ka kryer veprën penale të sulmit nga neni 184 par. 3 nënpar. 3.1 të KPRK-së.

II.

I akuzuari A. S. dhe D. S.:

Më datën 31.07.2020 në fshatin Çifllak, Komuna e Rahovecit, tjetrit i shkaktajnë lëndime të lehta trupore me dëmtim të përkohshëm të shëndetit, në atë mënyrë që ditën kritike, rreth orës 18.00 h, pas fjalosjes mes të miturit L.S. dhe Sh. K. të pandehurit nisen me veturë dhe tek shtëpia e N. M., takojnë A. K. tek dyert dhe me të shpejtë dalin që të dy nga vetura ku e godasin me grushta në kokë dhe trup të dëmtuarin A., duke i shkaktuar kështu lëndime në hundë dhe ndrydhje të indeve të buta të regjionit rreth syrit, që si të tilla kualifikohen në dëmtime të përkohshme të shëndetit sipas konstatimit të ekspertit mjeko – ligjor Dr. V. K. të dt. 25.09.2020.

Me këtë kanë kryer veprën penale në bashkryerje lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 1 nënpar. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

I.

Konform nenit 4, 6, 7, 17, 21, 38, 39, 40 par. 1 pika 1.2 dhe 1.3, 42, 43, 69 e 70, 184/3-3.1, 185/1-1.4-31, si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, të akuzuarit të parë, i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Të akuzuarit A. S.:

-për veprën penale nga neni 184 paragrafi 3 nënpar. 3.1 të KPRK-së, me dënim burgimi prej gjashtëdhjetë (60) ditësh. I akuzuari ka dhënë pëlqimin që dënimi me burgim të zëvendësohet me dënimin me gjobë.

Gjykata, në mbështetje të nenit 44 të KPRK-së, i shqipton:

Dënim me gjobë në shumë prej **treqind (300) Euro**, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe

-për veprën penale nga neni 185 par.1 nënpar. 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dënim me gjobë në shumë prej **dyqind (200) Euro**, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

Në bazë të nenit 76 paragrafin 1 dhe 2, e lidhur me nënparagrafin 2.4 të KPRK-së, si dhe dispozitave ligjore të shënuara më lart, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN UNIK ME GJOBË

Të akuzuarit **A. S.**, dënim me gjobë, në shumën e përgjithshme prej pesëqindë (500) Euro, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **njëzetepesë (25) ditëve**.

Të akuzuarit **D. S., i:**

SHQIPTON

-për veprën penale nga neni 185 par.1 nënpar. 1.4 lidhur me nenit 31 të KPRK-së, dënim me gjobë, në shumë prej dyqind (200) Euro, të cilin dënim është i obliguar ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi,

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 43 të KPRK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **dhjetë (10) ditëve**.

I dëmtuarit A. I. S. nga fshati Çifllak, Komuna e Rahovecit, kërkesën pasurore – juridike mund ta realizojnë në kontestin civil.

Obligohen të akuzuarit e lartcekur, që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor secili shumën prej tridhjetë (30) Euro, në emër të kompensimit për viktimat e krimit secili shumën prej tridhjetë (30) Euro, si dhe ekspertizën mjeko ligjore në shumë prej njëzet (20) euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale,

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.836/2020 të datës 25.01.2021, kundër të akuzuarve A. S. nga fshati Çifllak, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 184/3-3.1 të KPRK-së, dhe veprës penale lëndim i lehtë trupor në bashkryerje nga neni 185/1-1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, D. S. nga fshati Çifllak, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor në bashkryerje nga neni 185/1-1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 19.07.2022, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Nazmi Krasniqi dhe të akuzuarit A. S. dhe D. S. së bashku me av. S. M. nga Prizreni, sipas autorizimit, nuk kanë qenë prezent të akuzuarit të tjerë pasi që është veçuar dhe përfunduar procedura ndaj tyre.

Prokurori i shtetit Nazmi Krasniqi, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës, duke propozuar që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë e pranimit ose mospranimit të fajësisë, si dhe gjykata e ka njoftuar lidhur me efektet dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se të akuzuarit e kanë kuptuar aktakuzën, të njëjtëve iu ka dhënë mundësinë që të pranojnë ose të mos e pranojnë fajësinë, si dhe i ka njoftuar lidhur me efektet dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

I akuzuari i parë A. S., ka deklaruar se: e ka kuptuar akuzën, nuk ka nevojë për sqarime shtesë, e pranon fajësinë për këtë veprë penale për të cilën ngarkohet, duke premtuar gjykatës e një veprim i tillë nuk do të përsëritet si dhe i propozon gjykatës që të ketë mirëkuptim në shqiptimin e dënimit.

I akuzuari i dytë D. S., ka deklaruar se: e ka kuptuar akuzën, nuk ka nevojë për sqarime shtesë, e pranon fajësinë për këtë veprë penale për të cilën ngarkohet, duke premtuar gjykatës e një veprim i tillë nuk do të përsëritet si dhe i propozon gjykatës që të ketë mirëkuptim në shqiptimin e dënimit.

Mbrojtësi i të akuzuarit D. S. – avokati S. M. deklaron se: pajtohet me pranimin e fajësisë të deklaruar nga i mbrojturi i tij, pasi që një pranim të tillë i mbrojturi e ka bërë pas konsultimeve dhe këshillimeve të mjaftueshme si mbrojtës, i cili ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë dhe benifitet nga pranimi i fajësisë, të njëjtin pranim e ka bërë vullnetarisht pa ndonjë premtim, vuri në lajthim, apo kanosje ndaj gjykatës i propozoi që të bëjë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij, pasi që janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për një pranim të tillë. Po ashtu i propozon gjykatës që nëse do ta pranojë pranimin e fajësisë ti ketë parasysh që në rastin e matjes së dënimit, llojit dhe lartësisë së dënimit të shqiptuar ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese siç: pranimi i fajësisë, shprehja e keqardhjes dhe pendimi i thellë për veprën e kryer, karakteristikat personale pasi që i mbrojturi i tij asnjëherë më parë nuk ka qenë i dënuar apo të ketë rënë ndesh me ligjin, sjellja korrekte në gjykatë si dhe faktin se pas rastit me të dëmtuarit raportet i kanë të normalizuar dhe nga ajo ditë asnjëherë nuk kanë pasur ndonjë të keqe në mes vete, ndaj lut gjykatën që të mbrojturit të tij shqiptoj një dënim i cili do të jetë proporcional me peshën e veprës penale dhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i sanksionit penal e që ndaj të mbrojturit nuk do të ketë pasoja juridike në të ardhmen.

Prokurori i shtetit jep mendimin lidhur mbi pranimin e fajësisë i cili deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, pasi që të akuzuarit pranimin e fajësisë e kanë bërë me vullnet të lirë, pasi që i kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu ky pranim i fajësisë gjen mbështetje edhe në provat materiale dhe personale në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike në dispozitiv të aktakuzës, ku edhe formohen të gjitha elementet e veprës penale me të cilën ngarkohen të akuzuarit, ashtu që gjykatës që të bëjë aprovimin e pranimit të fajësisë që ndaj të akuzuarve të shqiptoj një dënim konform ligjit duke marrë për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara me KPPRK-së, si dhe të obligohen në shpenzimet e procedurës penale.

Gjykata konform dispozitave të nenit 365 të KPPK-së, e pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 326 të njëjtit Kod, për shkak se të akuzuarit në fillim të seancës të shqyrtimit fillestar janë deklaruar të fajshëm, në tërësi kanë pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk është lëshuar në procedurën e administrimit të provave.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarve është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se të akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPPK-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: - se të akuzuarit, kanë kryer veprën penale të Sulmit nga neni 184/3-3.1 të KPRK-së, dhe veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185/1-1.4.-31 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 184/3-3.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale të Sulmit e kryen: “Kur vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet ndaj viktimës së ndjeshme ose e motivuar sipas kombësisë, gjuhës besimit fetar ose mungesës së besimit fetar, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, orientimit seksual, ose për shkak të afërsisë me persona me njërën nga këto karakteristika të mbrojtura, kryesi dënohet me burgim deri në tre vjet, nga paragrafi 1 i këtij neni, si dhe neni 185/1-1.4 të KPRK-së, Kushdo që personit tjetër i shkakton lëndim të lehtë trupor, i cili rezulton me dëmtim të përkohshëm të shëndetit të personit tjetër, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. Lidhur me nenin 31: “Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale.”

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar në këto që janë cekur më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarit A. S. dhe D. S. i ka shpallur fajtor sipas aktakuzës së lartcekur, ngase në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale të të Sulmit nga neni 184/3-3.1 të KPRK-së, dhe veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185/1-1.4-31 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që edhe ti gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tyre, ndërsa gjendjen faktike e mori ashtu sikurse në aktakuzë dhe provat materiale të cilat i përmban aktakuza, e të cilat janë.

-Deklarata e të pandehurit – dëmtuarit A. S. dhënë në Polici me dt. 31.07.2020 dhe në Prokurori me dt. 13.10.2020;

-Deklarata e të pandehurit D. S. dhënë në Polici me dt. 01.08.2020.

-Deklarata e të pandehurit M. K. dhënë në Polici me dt. 31.07.2020 dhe në Prokurori me dt. 15.10.2020;

-Deklarata e të pandehurit H. K. dhënë në Polici me dt. 31.07.2020 dhe në Prokurori me dt. 16.10.2020;

-Deklarata e të pandehurit H. K. dhënë në Prokurori me dt. 23.10.2020;

-Deklarata e të pandehurit K. K. dhënë në Prokurori me dt. 16.10.2020;
-Deklarata e të dëmtuarit A. S. dhënë në Polici me dt. 31.07.2020 dhe në Prokurori me dt. 13.10.2020;
-Deklarata e të dëmtuarit (i mitur) Sh. K. dhënë në Polici me dt. 31.07.2020 dhe në Prokurori me dt. 02.11.2020;
-Deklarata e të dëmtuarit A. K. dhënë në Polici me dt. 31.07.2020 dhe në Prokurori me dt. 30.10.2020;
-Deklarata e dëshmitarit N. M. dhënë në Prokurori me dt. 12.01.2021;
-Deklarata e të paraqiturit si të dyshuar E. K. e dhënë në Prokurori me dt. 23.10.2021;
-Raporti Fillestar i Incidentit i dt. 31.07.2020;
-Raporti i shpejtë i dt. 31.07.2020;
-Raporti i policit Q. K. i dt. 01.08.2020;
-Urdhëresa e policisë e dt. 15.12.20, 20.01.2021;
-Ekspertiza mjeko-*ligjore e Dr. V. K. e dt. 29.09.2020;
-CD-ja;
Fotodokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë.

Gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohen, andaj gjykata ka vendosur ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarve gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarve: se janë të gjendjes së varfër ekonomike, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese nuk gjeti. Kështu që duke mos gjetur rrethana tjera rënduese për të akuzuarit, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit nga neni 38, dhe 48 i KPRK-së, dhe këto dënime si i tilla të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se dënimet e shqiptuara do të ndikojnë në parandalimin e të akuzuarve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tyre, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit që kërkesën pasurore – juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile, bazohet në nenin 463 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor bazohet në nenin 453 par.1 të KPPK-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u mor në kuptim të nenit 39 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit Nr.05/L – 036, për kompensimin e viktimave të krimit.

Nga sa u tha më lartë, e në vështrim të nenit 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.2020/147961 dt.18.07.2022

Sek. Juridike
Shemsije Shehu

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mizahir Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.